

# MEGAGROUT-100

## Llaç çimentoje i lëngshëm që nuk tkurret dhe me rezistencë të lartë për meremetime dhe përforcime

### Përshkrimi

Llaç i lëngshëm me bazë çimentoje me aditivë specialë, pa tkurrje dhe me rezistencë të lartë. Ai ofron:

- Rrjedhshmëri shumë të mirë pa u ndarë në shtresa.
- Fortësi fillestare dhe përfundimtare të lartë.
- Ngjitje efikase në hekur dhe beton.
- Rezistencë ndaj fryrjes së erës dhe dridhjeve.
- Depërtueshmëri e ulët e ujit.

Ai klasifikohet si llaç i kategorisë B sipas ASTM C 1107-99.

### Fushat e përdorimit

MEGAGROUT-100 aplikohet në shtresa me trashësi deri në 100 mm dhe është i përshtatshëm për:

- Meremetime në elementet e dëmtuara të betonit.
- Mbulimin me veshje të holla betoni në elementet ekzistuese të betonit.
- Mbushjen e boshllëqeve dhe kanaleve në elementet e betonit.

### Të dhënat teknike

Trajta:	pluhur çimentoje
Ngjyra:	gri
Uji që nevojitet:	3,50 kg për një thes 25 kg
Densiteti i volumit të llaçit të thatë:	1,75 ± 0,20 kg/litër
Densiteti i volumit të llaçit të njomë:	2,35 ± 0,20 kg/litër
Rezistenca në shtypje:	
• Pas 24 orësh:	55,00 ± 5,00 N/mm <sup>2</sup>
• Pas 7 ditësh:	78,00 ± 8,00 N/mm <sup>2</sup>
• Pas 28 ditësh:	90,00 ± 10,00 N/mm <sup>2</sup>

Rezistenca në përkulje: 11,00 ± 2,00 N/mm<sup>2</sup>

Koha e punueshmërisë: 1 orë në +20°C

Trashësia maks. për shtresë: 10 cm

### Udhëzimet e përdorimit

#### 1. Nënshtrësia

Sipërfaqja duhet të jetë e pastër, pa pluhur, graso etj. Gjithashtu, ajo duhet të bëhet e ashpër me qëllim që të garantohet ngjitja e duhur e llaçit të lëngshëm në të. Përpara përdorimit rekomandohet njomja totale e nënshtrësës.

#### 2. Përdorimi

Pas përzierjes me ujin MEGAGROUT-100 është një material i lëngshëm dhe me kokrriza të imëta, dhe pjesë të tij mund të rrjedhin në pjesët bashkuese të elementeve të veçantë të betoformës.

Prandaj, bashkimet e betoformës duhet të izoloohen me çimenton me ngrirje të shpejtë AQUAFIX ose me llaçin meremetues me mpiksje të shpejtë RAPICRET.

MEGAGROUT-100 hidhet gradualisht në 3 kg ujë dhe përzihet mirë me ndihmën e një mikseri me xhiro të ulëta (300 rrot/min), derisa të formohet një masë e lëngshme uniforme. Gjatë trazimit shtohet një sasi shtesë uji deri në 0,50 kg, derisa të arrihet rrjedhshmëria e dëshiruar e llaçit. Më pas, përzierja derdhet duke bërë kujdes që të evitohet formimi i filluskave të ajrit. Në çdo rast duhet të siguroheni që llaçi i lëngshëm ka mbushur çdo hapësirë midis armaturës dhe konstruksionit ekzistues.

Sipërfaqet e krijuara me MEGAGROUT-100 dhe që janë të ekspozuara në ajër të hapur duhet të mbahen të njoma të paktën për 24 orë, duke u mbuluar me leckë të lagura ose fletë polietileni.

# MEGAGROUT-100

## Konsumi

Rreth 21,5 kg/m<sup>2</sup>/cm të trashësisë së shtresës ose 2,1 kg për mbushjen e një vëllimi prej 1 litër.

## Ambalazhimi

MEGAGROUT-100 ofrohet në thasë letre 25 kg.

## Magazinimi

Të paktën 12 muaj në thasë të izoluar dhe në ambiente të thata.

## Shënime

- Temperatura gjatë aplikimit duhet të jetë nga +5°C deri në +30°C.
- Materiali që ka filluar të mpikset nuk duhet të zbutet përsëri me ujë.
- Produkti e ruan rrjedhshmërinë e tij për rreth 60 minuta në temperaturat midis +15°C dhe +25°C.
- Në temperatura të larta rekomandohet që thasët të ruhen në një vend të freskët, si dhe gjithashtu përzierja e materialit duhet të bëhet me ujë të ftohtë për të arritur rrjedhshmërinë e duhur për një kohëzgjatje të mjaftueshme (rreth 60 minuta).
- Në temperatura të ulëta dhe sa herë që kërkohet arritja e shpejtë e fortësisë, rekomandohet përzierja e materialit me ujë të vakët dhe mbrojtja nga i ftohti duke vendosur mbulesa izoluese termike mbi armaturë.
- Produkti përmban çimento, e cila vepron si alkaline me ujin dhe klasifikohet si irritues.
- Ndiqni udhëzimet për përdorimin e sigurt dhe masat paraprake të shkruara mbi paketim.



2032

### ISOMAT S.A.

17<sup>th</sup> km Thessaloniki – Ag. Athanasios  
P.O. BOX 1043, 570 03 Ag. Athanasios, Greece

10

2032-CPR-10.11

DoP No.:MEGAGROUT-100/1209-03

EN 1504-3

Concrete repair product for structural repair CC mortar (based on hydraulic cement)

Compressive strength: class R4

Chloride ion content: ≤ 0.05%

Adhesive Bond: ≥ 2.0 MPa

Carbonation resistance: Pass

Elastic modulus: ≥ 20 GPa

Thermal compatibility part 1: ≥ 2.0 MPa

Capillary absorption: ≤ 0.5 kg·m<sup>-2</sup>·h<sup>-0.5</sup>

Dangerous substances: comply with 5.4

Reaction to fire: Euroclass A1

### ISOMAT S.A.

BUILDING CHEMICALS AND MORTARS

#### ZYRAT QENDRORE – FABRIKA:

17th km Thessaloniki - Ag. Athanasios Road,  
P.O. BOX 1043, 570 03 Ag. Athanasios, Greece,  
Tel.: +30 2310 576 000, Faks: +30 2310 722 475

[www.isomat.eu](http://www.isomat.eu) e-mail: [info@isomat.eu](mailto:info@isomat.eu)